



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1001 Prot.

Tiranë, më datë 09.11.2020

VENDIM

Nr. 363, datë 06.11.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 06.11.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të sondazheve arkeologjike të realizuar nga person i licencuar në arkeologji z. Ols Lafe në kuadër të projektit të zbatimit “Agroturizëm Bote Farms”, Finiq, me aplikues Bote Farms;
 2. Subjekti aplikues duhet të procedojë me ndryshimin e njollës së projektit për zonat e sondazheve Nr.1 dhe 14, në të cilat u zbuluan gjetje arkeologjike ose të vijojë me koncept gërmimin/gërmimin e hapur në zonat e sipërcituara dhe vijimin me vendimarrjen në përfundim të procesit të gërmimit;
 3. Projekti i ndryshuar sipas gjetjeve arkeologjike të zbuluara ose koncepti i gërmimit arkeologjik të depozitohet për shqyrtim dhe vendimarrje pranë KKTKM;
 4. Gjetjet arkeologjike të zbuluara do të depozitohen në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
 5. Përgatitja e dosjeve për regjistrimin e tyre pranë Institutit Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore pas transportimit dhe dokumentimit të tyre në ambientet e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Vlorë;
 6. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
 7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 8. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Elva MARGARITI

SEKRETAR
Arta DOLLANI